



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

**VENDIM**

**Nr. 78, dt. 13.04.2016**

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 13.04.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratohet projekti i restaurimit të monumentit “Kisha e Shën Kollit”, Krutje e Sipërme, Lushnjë.  
*Në projekt përfshihet gjithashtu dhe ndërhyrja konservuese - restauruese në pikturën murale, ikonostas dhe në tavanët e drurit.*
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**

